REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fax/Br.str. 282
Datë/Datum. 18. 09. 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Datë: 18.09.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 17.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1722, të datës 24.08.2026, për shqyrtimin e dytë të ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 856, të datës 04.06.2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 24, të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2024, për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civile, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale

1. Për miratimin e ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale.

2. Ndryshim-plotësimit të Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale, e cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, parasheh mënyrën e organizimit dhe rregullimin e brendshëm, përgjegjësitë e njësive organizative si dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ndryshim-plotësimi i Rregullores Nr. 145/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale dhe Shtojca A - 1.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Administratës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Administratës, Drejtorive tjera Komunale dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani